

DEKLARATË PËR SHTYP

MABCO denoncon pengmarrjen juridike të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës

Lugano/Tiranë , 09.01.2026

Kompania zvicerane MABCO, zotëruese e **98% të aksioneve** të shoqërisë VIA (Vlora International Airport), ngre alarmin për një situatë të paprecedentë juridike dhe operacionale që po rrezikon seriozisht përfundimin e këtij investimi strategjik kombëtar.

Në një rast që sfidon çdo parim të sigurisë juridike dhe të drejtës tregtare, një aksioner i minorancës që përfaqëson vetëm **2% të kapitalit**, ka arritur të bllokojë vendimmarrjen e shumicës dërrmuese dhe të paralizojë ecurinë e punimeve.

Asimetria Juridike dhe Shkelja e Procesit të Rregullt

MABCO vëren me shqetësim një sërë vendimesh kontradiktore nga sistemi gjyqësor, të cilat duket se po përdoren si mjet për bllokimin e investimit:

- **Përmbysja e Hierarkisë Gjyqësore:** Megjithëse Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin që pezullonte të drejtën e votës së MABCO-s, vetëm një ditë më pas, një tjetër vendim i Shkallës së Parë ka rikthyer të njëjtin kufizim mbi bazën e kërkesave identike të aksionerit 2%. Kjo praktikë krijon një rreth vicioz ligjor që injoron autoritetin e gjykatave më të larta.
- **Mungesa e Transparencës:** Një sërë seancash dhe vendimesh janë zhvilluar pa njoftuar dhe pa thirrur palën mazhoritare (MABCO), duke shkelur parimin elementar të kontradiktorialitetit dhe procesit të rregullt ligjor.
- **Paradoksi i Vendimmarrjes:** Është juridikisht e pajustificueshme që vullneti i 2% të aksioneve të asgjësojë të drejtat pronësore të 98% të investimit, duke krijuar një precedent të rrezikshëm për çdo investitor të huaj në Shqipëri.

Sabotimi Operacional i Projektit

Përveç betejës juridike, MABCO denoncon veprimet e njëanshme të aksionerit të minorancës, z. Valon Ademi (përmes "2A Group"), të cilat synojnë paralizimin e punimeve në terren:

1. **Emërime të Paligjshme:** Emërimi i administratorit të ri është bërë në mënyrë të njëanshme, pa asnjë konsultim apo miratim nga asambleja e aksionerëve mazhoritarë.
2. **Dezinformimi Institucional:** Po përdoren raporte teknike të pasakta për të krijuar perceptimin e rremë të vonesave para autoriteteve mbikëqyrëse shtetërore.
3. **Bllokimi i Infrastrukturës Kritike:** Moskryerja e qëllimshme e detyrimeve nga kompania partnere po mban peng sisteme jetike si Terminalin, Kullën e Vrojtimit dhe lidhjen me rrjetin energjetik (OSHEE).

Thirrje për Ndërhyrje Urgjente

MABCO mbetet e angazhuar për të përfunduar këtë projekt me rëndësi jetike për Shqipërinë, por kërkon mbrojtjen e shtetit të së drejtës përballë kësaj tentative për "uzurpim" të investimit.

I drejtohem publikisht:

- **Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD):** Të hetojë me përparësi procedurat gjyqësore të ndjekura, të cilat kanë shmangur njoftimin e palës mazhoritare dhe kanë injoruar vendimet e Gjykatës së Apelit.
- **Institucioneve Shtetërore Mbikëqyrëse:** Të monitorojnë me integritet sabotazhin operacional që po i bëhet projektit, për të shmangur vonesat artificiale në një portë të ardhshme hyrëse të turizmit shqiptar.

MABCO do të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, kombëtare dhe ndërkombëtare, për të mbrojtur integritetin e investimit të saj zvicëran në Shqipëri.

Zyra për komunikim dhe media

Mabco Constructions SA

Bashkangjitur

- a. 2 faqe – Vendim për sigurimin e padisë, Gjykata e shkalles se pare e juridiksionit te pergjithshem Tirane, Nr. Regj. Them. 996 dates 17.10.2025
- b. 2 faqe - Shkurtime vendimi, gjykata e apelit te juridiksionit të përgjithshëm, Nr. Vendimi 1777 (30-2025-10924) i datës 22.12.2025
- c. 2 Faqe – Vendim mbi sigurimin e objektit të padisë, Gjykata e shkallës së parë e juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, dhoma civil, Regji. The. Nr. 17959 AKTI i datës 23.12.2025

Shtojca a. 2faqe

*Vendim per sigurimin e padise, Gjykata e shkalles se pare e juridiksionit te pergjithshem Tirane,
Nr. Regj. Them. 996 dates 17.10.2025*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

Nr. Regj. Them. 996

Data e regjistrimit 15.10.2025

Data e vendimit 17.10.2025

VENDIM

(Për sigurimin e padisë)

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

*Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me trup gjykues
të përbërë nga:*

Gjyqtar: Fatmir NDREU

asistuar nga sekretarja gjyqësore **Amantia Zisi**, sot, më datë 17.10.2025, në Tiranë, në
Dhomë Këshillimi, mori në shqyrtim çështjen civile me nr. **996** regj. them., e regjistruar në datë
15.10.2025, që i përket:

KËRKUES:

Shoqëria “2A Group” (Degë e shoqërisë së huaj), me NUIS
M12211048J, përfaqësues ligjor Valon Ademi, me adresë të Zyrës
Qendrore të Degës së Përfaqësimit në Shqipëri: Rruga “Faik
Konica”, pallati 6, shkalla 5, zyra 7, Tiranë 1010.

PALË E INTERESUAR:

Shoqëria “Vlora International Airport – VIA” SH.P.K., me
NUIS M118090021, me adresë: Rruga “29 Nëntori” pall. Constech,
objekti 2, kati 1, ZK 2679, Nr. Pasurie 440/384, Njësia
Administrative 7, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar marrjen e
çdo vendimi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve
të shoqërisë “Vlora International Airport-VIA” SH.P.K. të njoftuar
për tumbajtur me datën 20.10.2025 sipas atij rendi dite, deri në
zgjidhjen e çështjes me një vendim të formës së prerë.
2. Pezullimin e të drejtës së votës të ortakut të shumicës Shoqëria
“Mabco Construction SA” deri në regjistrimin e kontratës së shitjes
së kuotave të datës 03.04.2025 me objekt transferimin e kontratës së
shitjes së kuotave të datës 03.04.2025 për transferimin e 49% të
kuotave të kapitalit të shoqërisë VIA shpk tek blerësi 2A Group
sh.p.k.

BAZA LIGJORE:

Neni 42 i Kushtetutës. Nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës
Civile, Ligji nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërite
tregtare”, Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin

nenit 204/2 të K.Pr.Civile, brenda të cilit pala kërkuese duhet të paraqesë padinë e themelit në gjykatë.

Për sa më sipërargumentuar, gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 125, 202, 204, 205 e vijues të K.Pr.Civile,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar marrjen e çdo vendimi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Vlora International Airport – VIA” SH.P.K., të njoftuar për t’u mbajtur më datën 20.10.2025, sipas atij rendi dite, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, si dhe pezullimin e të drejtës së votës të ortakut të shumicës, Shoqërisë “Mabco Constructions SA” deri në regjistrimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025, me objekt transferimin e 49% të kuotave të kapitalit të shoqërisë VIA sh.p.k. tek blerësi 2A Group sh.p.k.
3. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon të llogaritet nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 17.10.2025.

**SEKRETARE
AMANTIA ZISI**

**GJYQTAR
FATMIR NDREU**

Shpenzime gjyqësore

Takse kerkese (parapaguar pala kerkuese) 200 leke


Njoftime (parapaguar pala kerkuese) 300 leke



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. Regj. Them. 1470 (21238-05017-30-2025)
Datë 23.09.2024**

**Nr. Vendimi 1777 (30-2025-10924)
Datë 22.12.2025**



SHKURTIM VENDIMI

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM E PËRBËRË NGA:

**RELATORE: VALBONA VATA
ANËTARE: ARTA DUKA
ANËTAR: SOKOL PINA**

me sekretare seance Albana Bicprendi, në Tiranë, më datë 22.12.2025, në seancë gjyqësore, mori në shqyrtim ankimin për çështjen administrative civile nr.1470(21238-05017-30-2025) Regj.Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

Shoqëria "2A Group" (Degë e shoqërisë së huaj), me NUIS M12211048J, përfaqësues ligjor Valon Ademi, me adresë të Zyrës Qendrore të Degës së Përfaqësimit në Shqipëri: Rruga "Faik Konica", pallati 6, shkalla 5, zyra 7, Tiranë 1010.

PALË E INTERESUAR:

Shoqëria "Vlora International Airport - VIA" SH.P.K., me NUIS M11809002I, me adresë: Rruga "29 Nëntori" pall. Constech, objekti 2, kati 1, ZK 2679, Nr. Pasurie 440/384, Njësia Administrative 7, Tiranë.

Shoqëria "MABCO Constructions SA", shoqëri e së drejtës zvicerane, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Kantonit Ticino me nr. regjistrimi CHE-101.624.994, me seli në adresën: Via Cattori 7, 6900 Paradiso, Lugano, Zvicër, me përfaqësues ligjor Kryetarin e Këshillit të Administrimit, z. Emin Pacolli; e mbrojtur dhe e përfaqësuar nga av. Ervin Metalla, me leje ushtrimi profesioni nr. 8713, NUIS M0131605R, me seli në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallatet e Lanës (italiane), nr. 1, ap. 7, dhe adresë emaili: metallalawfirm@gmail.com, i zgjedhur me prokurë të posaçme nr. 2125 rep., nr. 480 kol., datë 20.10.2025, përpiluar nga notere Helena B. Shëngiergji.

OBJEKTI:

1. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar marrjen e çdo vendimi në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Vlora International Airport-VIA" SH.P.K. të njoftuar për tu mbajtur me datën

20.10.2025 sipas atij rendi dite, deri në zgjidhjen e çështjes me një vendim të formës së prerë.

2. Pezullimin e të drejtës së votës të ortakut të shumicës Shoqëria "Mabco Construction SA" deri në regjistrimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025 me objekt transferimin e kontratës së shitjes së kuotave të datës 03.04.2025 për transferimin e 49% të kuotave të kapitalit të shoqërisë VIA shpk tek blerësi 2A Group sh.p.k.

BAZA LIGJORE:

Neni 42 i Kushtetutës. Nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, Ligji nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligji nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin Nr. 1777(30-2025-10924) të datës 22.12.2025,

VENDOSI

Ndryshimin e vendimit nr.996 Regj. Them, date 17.10.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në këtë mënyrë:

Pranimin pjesërisht të kërkesës.

Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, Shoqëria "Mabco Constructions Sa" për çdo vendim që lidhet me tjetërsimin e 47% të kuotave në Shoqërinë "Vlora International Airport -VIA" Shpk në favor të tretëve, deri në përfundim të këtij gjykimi.

Kundër vendimit lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 diteve, nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tirane, me 22.12.2025.

ANËTARE

ARTA DUKA

ANËTAR

SOKOL PINA

RELATORE

VALBONA VATA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANE

NR 17959 AKTI

Datë 23.12.2025

Datë 17.12.2025 regjistrimi

V E N D I M

“MBI SIGURIMIN E OBJEKTIT TE PADISE ”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARE: MARIANA SHEGANI (DEDI)

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Erjada Pepa** , sot me dt **23.12.2025**. mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen civile me **Nr. 17959 Akti**, që i përket:

PADITES: **1.Shoqëria “Vlora Internacional Airport-VIA” SHPK** me NUIS M11809002I, me adresë: Rruga “29 Nentori” pall Constech. objekti 2. katin 1, ZK 2679, nr. pasurie 440/384, Njesia Administrative 7 Tiranë përfaqësuar nga Administratori Vegim Hoxha, me adrese elektronike e-mail valon.lluka@mabetexholding.com dhe numer kontakti tel: 0696050600. perfaqesuar me Prokure te Posacme Nr 7824 Rep/3850 kol date 17.12.2025 nga avokat Taulant Godroli.

2.Shoqëria “2A Group” (Degë e shoqërisë së huaj), me NUIS M12211048I, perfaqësues ligjor Valon Ademi, me adrese te Zyres Qendrore te Deges se Perfaqësimit ne Shqipëri: Rruga “Faik Konica”, pallati 6, shkalla 5, zyra 7 Tiranë 1010 perfaqesuar nga administratori Kushtrim Krivaqa me adrese elektronike e mail: 2agroupshpk.al@gmail.com aagroupks@gmail.com dhe numer kontakti 0692064777.

I PADITUR: Shoqeria Mabco Constructions Dege e shoqërisë së huaj rregjistruar me numër NUIS M21414035V me datën 14.02.2022 me seli ne Tirane Rruga "29 Nëntori", Pall. Constech, Objekti 2, Kati 1, ZK 2679 , Nr Pasurie 440/384 , Njësia Adm. Nr 7 , Tiranë përfaqësuar nga Sazan Gorishova me te dhëna kontakti e-Mail: sazan.gorishova@mabetex.al dhe numër kontakti tel: 068607070.



vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Në këtë kuptim argumenton dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Vendimin Nr 22 datë 19.01.2011 :

"Qëllimi i marrjes së masës për sigurimin e padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe legjislacionit ndërkombëtar është (i) jo vetëm siguri i së drejtës e cila përbën dhe tërësinë e kërimeve që do të shtrojnë paditësi në padinë e tij, (ii) por në të njëjtën kohë dhe ajo që është më e rëndësishmja është që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor, i cili do të realizohet mes palëve në të ardhmen, në mënyrë që kjo e drejtë të cilën paditësi kërkon të realizojë dhe të njohë nëpërmjet një procesi gjyqësor, të mos jetë e kërcënuar nga një dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, dhe që vendimi përfundimtar të mos mbetet i pa ekzekutueshëm".

Ne keto rrethana, Gjykata vlerëson se marrja e masës së sigurimit të padisë është mjet efektiv që vete ligji në rastin e përjashtimi të ortakut ka parashikuar me qëllim që të beje të mundur pasjen efektivitet të vendimit të gjykatës në eventualitet të pranimit të padisë si dhe kufizimin e cdo veprimit që ortaku mund të ndermarre gjatë kohës që po vlerësohet sjellja e tij në shoqëri për të mos lejuar veprime të mëtejshme me formën apo veprimtarinë e shoqërisë si dhe veprime me të tretet në emër e për llogari të shoqërisë.


Sa me sipër provohet nga aktet e paraqitura deri në këtë moment të shqyrtimit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 125, 202, 203, 205 të K.Pr.Civile

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës për sigurimin e objektit të padisë.
- Pezullimin e të drejtës së votës së ortakut Shoqëria Mabco Construction degë e shoqërisë së huaj, në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Vlora Internacional Aeroport-VIA" shpk, si dhe cdo të drejtë që rrjedh nga zotërimi i kuotës në këtë shoqëri derisa vendimi të marrë formë të prerë.
- Kunder vendimit mund të behet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Tirane sot me dt 23.12.2025.

SEKRETARE

ERJADA PEPA

GJYOTARE

MARIANA SHEGANI (DEDI)

VERTETOHET NJESIA
ME ORIGINALIN
K / SEKRETARE
MIMOZA Tafa

